



Pranimi / Dorëzimi / Puniljena / Prilato / Retrievca / Delivery	03.06.2021	1	viti god. year
Organ / Njësia / Org / Unit	Nr. Prot / Br. Prot / Prot No	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKIMSHICK	2846/2021		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A nr.374/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Sabile Avdyli, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësi të procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.3067/19 të datës 13.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.660/2019 të datës 24.10.2019, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr. "Vehbi Ibrahim" "Nr.18, Lagja Zabel, Gjilan, kundër Vendimit me numër reference SMBNJD-316 të datës 23.09.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë Pyjore të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 02.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr. 660/2019 të datës 24.10.2019, e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër reference SMBNJD-316 i datës 23.09.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë Pyjore të Kosovë

A r s y e t i m

Agjencia Pyjore e Kosovës bazuar në Autorizimin e datës 15.07.2019 të Departamentit për Administrimin e Shërbimit Publik në Ministrinë e Administratës Publike, me datë 17.07.2019 ka shpallur konkursin e brendshëm për pozitën "Menaxher i Personelit". I njëjti për arsye të balancimit etnik është vazhduar edhe për 7 ditë, respektivisht deri me 01.08.2019, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi në pozitën e Zyrtarit për çështje ekonomike në DKR-APK Gjilan.

Me datën 19.08.2019, Agjencia Pyjore e Kosovës ka shpallur njoftimin me numër ref.SBNJD-281/19 për kandidatin e suksesshëm për pozitën "Menaxher i Personelit", e sipas të cilit kandidatja është vlerësuar si kandidatja me më shumë pikë gjithsej 451 pikë apo 90.20%.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 19.08.2019 për shpalljen e kandidatit të suksesshëm, më datën 13.09.2019 ka parashtruar ankesën me numër protokolli 3649 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Agjencinë Pyjore të Kosovës. Ky i fundit me Vendimin me numër reference SMBNJD-316 i datës 23.09.2019 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar.

Ankuesi brenda fatit ligjore përmes emalit me datë 24.10.2019 parashtron ankesë kundër Vendimit me numër reference 3816/19 të datës 23.09.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë Pyjore të Kosovës, me numër protokolli 5042/2019 e regjistruar me A.nr.660/2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 30.10.2019 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Agjencia Pyjore e Kosovës. Agjencia Pyjore e Kosovës më datë 05.11.2019 ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit për vendosje ka udhëzuar ankuesin për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 31.03.2021 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.3067/2019 të datës 13.04.2021, ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoje dhe të vendos për ankesën e datës 24.10.2018 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 5042/2019 të datës 28.10.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail i datës 24.10.2019 për parashtrim të ankesës, Ankesa e datës 05.03.2019 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të APK-së ; CV e ankuesit; Formulari për aplikim i datës 17.01.2019, kopja e konkursit e datës 04.01.2018; Letër rekomandimi i datës 18.01.2018; Ftesë për seancë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimi i datës 27.03.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ankesa e datës 13.09.2019 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në APK; Akt emërimi i datës 31.01.2012; Certifikatë e datës 26.06.2018; certifikatë për trajner e vitit 2017; certifikatë e vitit 2010; Certifikate e vitit 2014; certifikatë e vitit 2008; certifikatë e vitit 2016; Referencë e datës 10.08.2016; Kursi për licencimin e kursit për ngasje i datës 09.07.2003; Licencë e datës 15.11.2002; Vendim i datës 18.04.2013 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; Kontratë pune e datës 08.05.2008 në Drejtorinë e Arsimit dhe Kulturës në Gjilan; Vërtetim i datës 17.12.2004; Vërtetim i datës 28.09.2006; Vërtetim i datës 11.06.2015; Diploma e masterit vitit 2016; Ftesë për seancën e parë të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave e datës 17.09.2019; Njoftimi i datës 19.08.2019 për kandidatin e përzgjedhur; Kopja e konkursit e datës 17.07.2019; Informatë lidhur me përzgjedhjen e kandidatit e datës 05.02.2018; kopja e testit me shkrim e Njoftimi për zgjatjen e afatit të pranimit të aplikacioneve ; Vendimi i datës 23.09.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Agjencisë; E-mail zyrtar i datës 25.09.2019 kur ju ka përcjell Vendimi i KZKA-së; Formulari i aplikimit për Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2017; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2018; Dëshmi mbi pranimin e aplikacionit e datës 24.07.2019; kopja e testit me shkrim e datës 08.08.2019; Shpallja e konkursit të brendshëm 17.07.2019; Njoftimi për zgjatjen e afatit të pranimit të aplikacioneve; Vendimi i datës 23.09.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i APK-së; E-mail zyrtar i datës 25.09.2019; Kërkesa për punësim e datës 24.07.2019 për bashkë me dokumentet e kërkuara; Kërkesa për punësim e datës 24.07.2019 për bashkë me dokumentet e

Lidhur me pretendimin ankimor së kandidatja e zgjedhur nuk ka plotësuar kriteret e konkursit, Kolegji duke i referuar Diplomës Universitare më numër 3097 të datës 10.04.2015 të lëshuar nga Fakulteti Juridik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", ka konstatuar se

me datë 04.04.2009 ka përfunduar studimet themelore dhe ka marrë titullin Bachelor i Drejtësisë, ndërsa sipas Aktit Emërim ZPD-131/2013 të datës 30.04.2013, vërtetohet se e njëjta me datë 30.04.2013 është emëruar në pozitën e Zyrtares së Personelit në Agjencinë Pyjore të Kosovës, ndërsa sipas Ndryshim dhe Plotësim të Aktit të Emërimit SBNJD-22/2018 të datës 06.02.2018, e njëjta është emëruar si Udhëheqëse e Sektorit për Hartimin e Legjislacionit duke filluar nga data 07.02.2018 e deri në aplikimin e saj në këtë pozitë, e mbi këtë konstatim rrjedhë se kandidatja

ka plotësuar kriteret e konkursit në aspektin e kualifikimit arsimor dhe të përvojës së punës, e në këtë kuptim pretendimi ankimor i ankuesit nuk është i bazuar.

Nuk qëndron pretendimi ankimor i ankuesit se konkursi nuk është shpallur në pajtim me nenin 5 të Rregullores Nr.21/2011 për Procedurën e Avancimit të Shërbyesve Civilë, Kolegji bazuar në sqarimin e organit të punësimit në përgjigjen në ankesë ka gjetur së Konkursi për pozitën në fjalë është shpallur në tabelën e shpalljes të Agjencisë Pyjore të Kosovës dhe në SIMBNJ, e në këtë kuptim shpallja është në pajtim me nenin 5 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr.21/2011 për Procedurën e Avancimit të Shërbyesve civil me të cilin ehte përcaktuar se: *shpallja për avancim bëhet nga njësia e personelit brenda institucionit përkatës në vendet e përshtatshme ku kanë qasje të gjithë nëpunësit civilë. 2. Shpallja e avancimit fillimisht bëhet brenda njësisë së institucionit.*

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit së procedura e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me parimet e Procedurës për Avancim sipas Rregullores Nr.21/2011 për Procedurën e Avancimit, Kolegji vlerëson së organi i punësimit ka shpallur konkurs të brendshëm për pozitën në fjalë duke ofruar mundësi të zhvillimit të karrierës për zyrtaret e brendshëm, e i cili konkurrim ka qenë i hapur me të drejtë konkurrimi të çdo zyrtari të interesuar për pozitën në fjala.

Në kuptim të vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore, Kolegji ju referua edhe Nenit 27 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *Avancimi nga një pozitë më e ulët në pozitë më të lartë funksionale ose nga një gradë më e ulët në një gradë më të lartë brenda pozitës funksionale lejohet në bazë të: 1.1. disponueshmërisë së pozitave të lira; 1.2. plotësimit të të gjitha kushteve të caktuara për atë pozitë; 1.3. kalimit të kohës së caktuar minimale; dhe 1.4. kalimit me sukses të testimit, dëshmimit të meritës, aftësive dhe kompetencës profesionale, si dhe Rregullores Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë përkatësisht nenin 9 me të cilin përcaktohet se: 1. Kriteret për avancim në karrierë të nëpunësit civil janë: 1.1. kalimi i kohës minimale në gradën e tyre ekzistuese në bazë të rregullave të përcaktuara më këtë Rregullore; 1.2. plotësimi i kërkesave profesionale dhe kualifikimet e kërkuara për pozitën përkatëse; 1.3. kalimi me sukses të testimit me shkrim dhe me gojë; 1.4. rezultatet e vlerësimit në punë të jenë: mirë, shumë mirë ose shkëlqyeshëm; 1.5. të mos jetë në procedurë disiplinore; 1.6. të mos jetë i ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore në 3 vitet e fundit; 1.7. të mos jetë iniciuar ndonjë procedurë penale. Ndërsa lidhur me kohën për avancim nenin 10 i po të njëjtës Rregullore ka paraparë se: *Koha minimale për avancim nga një gradë më e ulët në një gradë më të lartë ose nga një kategori funksionale më e ulët në kategorinë funksionale më të lartë, është 3 vite kur performanca e nëpunësit civil është vlerësuar mirë dhe shumë mirë, ndërsa 2 vite kur performanca e tij/saj është vlerësuar shkëlqyeshëm, e mbi këtë bazë ligjore si dhe mbështetur në provat e administruara të lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesja ka plotësuar kërkesat për avancim gjegjësisht ankuesja ka kaluar kohën minimale për avancim pasi që nga nda data 30.04.2013 është emëruar në pozitën e Zyrtares së Personelit në**



Agjencinë Pyjore të Kosovës, ka plotësuar kualifikimet e kërkuar profesionale ashtu siç është përcaktuar me Konkursin e datës 17.07.2019, ka kaluar testin me shkrim dhe gojë, ndërsa lidhur me vlerësimin e performances së punës për vitin 2018 ka vlerësim “shkëlqyeshëm” kurse për vitin 2016 dhe 2017 “shumë mirë” dhe se në shkresat e lëndës nuk gjenden dëshmi për ndonjë masë disiplinore të shqiptuar ndaj kandidatës së zgjedhur apo se ndaj të njëjtës është iniciuar ndonjë procedurë penale.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës lidhur me zhvillimin e procedurës rekrutuese si dhe pas trajtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit konstaton që procedura e rekrutimit për pozitën “Menaxher i Personelit” në Agjencinë Pyjore të Kosovës është zhvilluar në pajtim me nenin 3 paragrafin 9, nenin 5 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 11 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: *“Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës, si dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.*

Bazuar në shkresat si me larte Kolegji konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Agjencisë Pyjore të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit SMBNJD-316 të datës 23.09.2019, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike lidhur me çështjen e kontestuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.660/2019

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Procesmbajtëse

Ardita HAXHIKAJ DEMI

Ardita Haxhikaj Deme
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesi
- Kryeshefit të Agjencisë Pyjore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë Pyjore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

